

VENDIM

Nr. 632, datë 21.11.2001

PER MENYREN E PAGESES SE BANESES QE TE VERBRIT E GRUPIT TE PARE PERFITOJNE NGA ENTI KOMBETAR I BANESAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr.8098, datë 28.3.1996, "Për statusin e të verbrit", me propozimin e ministrit të Punëve Publike dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit, nëpërmjet Entit Kombëtar të Banesave, për trajtimin me përparësi nga shteti të planifikojë fonde për strehimin e të verbërve të grupit të parë, në bazë të kërkesës së Shoqatës të së Verbërve të Shqipërisë.
2. Çdo i verbër i grupit të parë përfiton falas një dhomë, me sipërfaqe 12 5 14 M2 mbi sipërfaqen normative dhe përshtatjen e banesës sipas kushteve fizike. Për banesat që do t'u jepen qytetarëve me statusin e të verbrit të përdoren normat ekzistuese të projektimit, deri në nxjerrjen e normave të projektimit për të verbrit. Shpenzimet për përshtatjen e banesës të mbulohen nga buxheti i shtetit.
3. Shpenzimet operacionale, që do të kryhen nga Enti Kombëtar i Banesave për banesat, e ndërtuara apo të blera në tregun e lirë, të përballohen nga fondet e dhëna për strehim ose t'i njihen kësaj të fundit si shlyerje detyrimi ndaj buxhetit të shtetit.
4. Të verbrit, e pastrehë, të grupit të parë, të shlyejnë diferencën ndërmjet vlerës së banesës, me përfitimet nga statusi i të pastrehut dhe nga ky vendim.
5. Kur të verbrit e grupit të parë nuk pranojnë të marrin dhomë tepër, vlera e kësaj dhome zbritet nga vlera e banesës, që do të përfitojnë.
6. Kur të verbrit, e pastrehë, të grupit të parë kanë përfituar banesë nga Enti Kombëtar i Banesave, u bëhet zbritja e vlerës së përcaktuar në pikat 2 dhe 3 të këtij vendimi. Enti Kombëtar i Banesave nuk u detyrohet qytetarëve nëse përfitimi falas rezulton më i lartë se masa e kredisë, që ata duhet të shlyejnë.
7. Kërkesat për strehim administrohen nga Shoqata e të Verbërve të Shqipërisë, e cila përcakton radhën dhe përparësitë e trajtimit, strukturat që i takojnë çdo familjeje, duke specifikuar edhe dhomën shtesë, dhe i dërgon këto dokumente, brenda datës 1 gusht të çdo viti, pranë Ministrisë së Punëve Publike dhe Turizmit. Dokumentacioni i plotë i dërgohet Entit Kombëtar të Banesave. Ky dokumentacion përmban edhe dokumentin zyrtar të librezës së verbërisë, sipas modelit të përcaktuar nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, në bashkëpunim me Shoqatën e të Verbërve të Shqipërisë, si dhe vërtetimin nga bashkia, për statusin e të pastrehut.
8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Turizmit, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, organet e qeverisjes vendore dhe Enti Kombëtar. i Banesave, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI
ILIR META